



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Përgjigjet ndaj Komenteve (KEDS)

Shqyrtimi i tetë i tarifave të energjisë elektrike

SHTE8 (2014-2015)

Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara

DEKLARATË

Këto përgjigje janë përgatitur nga ZRRE-ja vetëm për qëllime informative. Dokumenti nuk duhet të konsiderohet se paraqet vendim të ZRRE-së.

24 qershor 2014

Përmbajtja

1	Hyrje	1
2	Struktura e këtij dokumenti	1
3	Komentet lidhur me Balancën e Energjisë	2
3.1	Balanca e përdorur	2
3.2	Kostot e Importit dhe Eksportit të energjisë elektrike	2
3.3	Humbjet e Energjisë Elektrike	3
4	Kostot e Shitjes me Shumicë	3
5	MAR-i i OSSH-së	4
5.1	Shturja e Funksioneve në mes OSSH dhe FPEE	4
5.2	Kostot e Humbjeve	4
5.3	Kalkulimi i zhvlerësimit dhe kthimit	5
6	MAR-i i Furnizuesit Publik	5

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është në procesin e Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE8) që nënkupton llogaritjen e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) të kompanive të rregulluara për vitin tarifor 2014-2015.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike (FPPE) kanë dorëzuar aplikacionin e tyre për të Hyra Maksimale të Lejuara në shkurt 2014. Pas shqyrtimit të aplikacionit të tyre, ZRRE ka dërguar Raportin Vlerësues në të cilin ka paraqitur vërejtjet e ZRRE-së mbi aplikacionin e dorëzuar nga të licencuarit. Përgjigjet e KEDS i janë dorëzuar ZRRE-së më 13 qershor 2014.

Ky Dokument paraqet përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KEDS-it të pranuar lidhur me Raportin Vlerësues dhe ka për qëllim që të ju komunikoj palëve të interesit qëndrimet e ZRRE-së lidhur me komentet e pranuar si dhe propozimet e ZRRE-së lidhur me të Hyrat Maksimale të Lejuara. Ky dokument ku janë të përfshira përgjigjet e ZRRE-se se bashku me Raportet vlerësuese finale të DTC-së do të shqyrtohen nga Bordi i ZRRE-së në seancën publike para vendimit final për aprovimin e MAR-it.

Vendimi i lëshuar nga ZRRE do të përcaktojë MAR-in për të Licencuarit KEDS OSSH dhe KEDS FPPE. Ngarkesat/tarifat të cilat do t'i aplikojnë këta të Licencuar duhet të jenë në përputhje me metodologjitë e përcaktimit të ngarkesave të miratuara nga ZRRE, përkatësisht me Rregullën për Vendosjen e Çmimeve.

Ky dokument duhet të lexohet së bashku me Raportin Vlerësues fillestar të ZRRE-së, Komentet e KEDS-it si dhe Raportin Vlerësues përfundimtar. Këto tri dokumente janë të publikuara në ueb-faqen e ZRRE-së.

2 Struktura e këtij dokumenti

Duhet të theksohet se KEDS-i ka parashtruar komente të hollësishme lidhur me shqyrtimin dhe propozimet fillestare të ZRRE-së. Kjo gjë është në të mirën e të gjitha palëve të përfshira në proces, duke pas parasysh se gjithmonë ekziston mundësia e lëshimeve të paqëllimshme gjatë kalkulimeve, përkatësisht gjatë vlerësimit të të hyrave për këta të Licencuar.

Me qëllim që ky Dokument të jetë sa më lehtë i kuptueshëm për të gjithë lexuesit e tij ZRRE e ka organizuar duke u bazuar në titujt e komenteve të KEDS-it. **Duhet të theksohet se përdorimi i strukturës së këtij Dokumenti me strukturën e njëjtë të komenteve nga ana e KEDS, nuk do të thotë që ZRRE është pajtuar me komentet e dërguara nga i Licencuari.** Me qëllim që ky dokument mos të jetë shumë i ngarkuar, ZRRE ka vlerësuar që do jetë shumë më e kuptueshme të gjitha palët që këto komente të jepen të përmbledhura dhe përcillen nga përgjigjet e ZRRE-së ndaj tyre në

vazhdim të këtyre komenteve. Të gjithë të interesuarit për komente të plota mund t'iu referohen komenteve të ofruara nga KEDS-i¹.

3 Komentet lidhur me Balancën e Energjisë

3.1 Balanca e përdorur

KEDS komenton se Bilanci i Energjisë i prezantuar në Raportin Konsultativ të ZRRE-së nuk është në përputhshmëri me Bilancin Zyrtar të aprovuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. KEDS ka paraqitur një tabelë ku ka prezantuar qëndrimet e tyre lidhur me këtë çështje.

ZRRE rithekson se Balanca e Energjisë e aprovuar nga MZHE është përdorur si bazë për llogaritjen e balancës të përdorur për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara të të Licencuarve. Në këtë drejtim, ZRRE iu është referuar vlerave të parashikuara të shitjes në nivel të shpërndarjes dhe të transmisionit si dhe nivelit të parashikuar të gjenerimit vendor dhe i është pershtatur rrethanave të krijuara në sektorin e energjisë.

ZRRE po ashtu ka aplikuar cakun për reduktimin e nivelit të humbjeve në shpërndarje, të paracaktuar në Vendimin 399 të ZRRE-së. Në këtë mënyrë, niveli i lejuar i humbjeve për Vitin e dytë Relevant është llogaritur duke zbritur 3 pika përqindjeje nga niveli i humbjeve i lejuar në Vitin e parë. Pjesa e mbetur e balancës së energjisë është përcaktuar duke barazuar diferencat në mes të gjenerimit vendor, ngarkesës si dhe nivelit të parashikuar të eksportit.

Për arsyet e përmendura më lart, ky koment i KEDS nuk ka ndryshuar propozimin fillestar të ZRRE-së.

3.2 Kostot e Importit dhe Eksportit të energjisë elektrike

KEDS ka shprehur shqetësimin se shtyrja e remontit të njësisë A5 për vitin e ardhshëm do të jetë e pamundur duke pasur parasysh aksidentit e datës 6 qershor. Me atë rast të gjitha njësitë e TCA janë jashtë funksionit dhe ende nuk dihet se kur këto njësi mund të jenë të gatshme për operim pas dëmeve të shkaktuara. Kjo do të ketë ndikim në të hyrat që do të mund të arkëtohenin nga eksporti i kësaj energjie të paraparë me Bilancin e Aprovuar nga MZHE dhe po ashtu do të ketë ndikim edhe në kostot e Importit që rrjedhin si rezultat i daljes së këtyre njësive nga operimi. Njëkohësisht KEDS ka theksuar se ZRRE nuk e ka marrë parasysh projektin e kogjenerimit që pritet të realizohet këtë vit.

ZRRE pajtohet me shqetësimet e KEDS-it se aksidenti i datës 6 qershor do të ketë ndikime në të hyrat që janë planifikuar të realizohen nga eksporti i energjisë dhe po ashtu edhe në kostot shtesë të importit. Duhet të theksohet se ZRRE është në kontakt me KEK-un dhe pritet të ketë një raport nga ana e tyre lidhur me këtë çështje. Prandaj në këtë fazë do vazhdojmë me vlerësimet e mëhershme

¹ "Përgjigje ndaj Raportit Vlerësues të ZRRE-së", KEDS, 20 qershor 2014. Në dispozicion nga uebfaqja e ZRRE-së në www.ero-ks.org në menynë Çmimet dhe Tarifat.

dhe pas një vlerësimi të detajuar të ndikimit të këtij aksidenti, ZRRE do të rivlerësojë veprimet e mëtutjeshme.

Sa i përket projektit të ko-gjenerimit, ZRRE e ka analizuar me shumë kujdes këtë çështje dhe vlerësojmë se ndikimi i këtij projekti do të ketë ndikim pozitiv për sektorin e energjisë, ku perveq kostove do të ketë edhe perfitime nga zvoglimi i konsumit në kohën e piku kur kostot e importit janë me të larta. ZRRE e rregullon sektorin e energjisë elektrike dhe energjis termike dhe kostot që shkaktohen nga ky projekte do të alokohen tek i licencuari i cili i shkakton ato.

3.3 Humbjet e Energjisë Elektrike

KEDS ka komentuar se nuk e kupton arsyen se pse ZRRE nuk ka marrë Vendim për kërkesën e tyre për të ricaktuar nivelin e humbjeve. KEDS ka theksuar se vonesat në zgjidhjen e kësaj çështjeje i paraqesin problem për të komentuar në vlerësimin e MAR-it të FPPE-së dhe të OSSH-së.

ZRRE rithekson se ndryshimi i të gjitha vendimeve që kanë ndikim në tarifa duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik. Prandaj, ZRRE-ja duhet të konsultojë palët e interesuara relevante duke përfshirë edhe Njësinë e KEDS-it Pas Privatizimit për të marrë mendimin e tyre lidhur me këto çështje. Vlen të theksohet se ZRRE ka kërkuar përmes kërkesës zyrtare, ku i është adresuar komitetit nder-ministror për privatizim, përmes Njësisë së KEDS-it pas Privatizimit ku është kërkuar mendimi ligjor për kufizimet që rrjedhin nga transaksioni i privatizimit i cili ka kaluar përmes prokurimit publik. Deri më tani ZRRE nuk ka marrë përgjigje nga kjo njësi prandaj nuk ka pozicion rreth ndryshimit të Vendimit. Rrjedhimisht, ZRRE do të vazhdojë të aplikojë Vendimin në fuqi.

Për arsyet e përmendura më lart, ky koment i KEDS-it nuk ka pasur ndikim në propozimin fillestar të ZRRE-së.

4 Kostot e Shitjes me Shumicë

Komentet e KEDS-it lidhur me vëllimin e importit dhe eksportit të energjisë në kuadër të ËHPC-së janë adresuar në Seksionin 3.2 të këtij Dokumenti. Megjithatë KEDS ka theksuar se konsumi vetanak i gjeneratorit do të duhej të ishte zbritur nga ZRRE me rastin e llogaritjes të Mesatares së Ponderuar të Kostos së Blerjes së Energjisë.

ZRRE pajtohet me këtë koment të KEDS dhe ka azhurnuar Modelin Tarifor si dhe Raportin Përfundimtar Vlerësues për të reflektuar këtë ndryshim.

KEDS po ashtu ka komentuar se marzha me pakicë duhet të llogaritet para përshtatjes së kostove me shumicë dhe jo pas përshtatjes së këtyre kostove siç është propozuar nga ZRRE në Raportin fillestar. Konsiderojmë se KEDS e ka keqkuptuar metodologjinë e llogaritjes së ËHPC-së pasi që ZRRE e ka llogaritur RETM-në pikërisht para përshtatjes së kostove me shumicë. Në kryerjen e kësaj llogaritjeje është marrë parasysh formula:

$$WHPC_t = (WHCC_t + WHEC_t) * (1 + RETM_t) + (WHPC_{t-1} - WHPC_{t-1}) * (1 + I_t)$$

5 MAR-i i OSSH-së

KEDS ka theksuar se është pajtuar me Vlerësimet e bëra nga ZRRE, përpos disa çështjeve të cilat janë të sqaruara më poshtë.

5.1 Sthurja e Funksioneve në mes OSSH dhe FPEE

KEDS në aplikacionin e tyre për të hyrat maksimale për OSSH-në dhe FPEE-në dhe ka kërkuar rialokimin e të hyrave sipas funksioneve të licencës dhe ka prezantuar kostot e të licencuarve duke u bazuar në funksionet e Licencës. Ata kanë kërkuar të behet ky rialokim duke pasur parasysh se një gjë e tillë nuk do të ketë ndikim në tarifat përfundimtare të konsumatorëve të rregulluar dhe si pasojë e mos-marrjes parasysh të kësaj kërkesë kemi një ndryshim të madh në mes të kërkesës së KEDS-it dhe Raportit vlerësues të ZRRE-së.

ZRRE pajtohet me kërkesën e KEDS për alokimin e kostove në mes të OSSH-së dhe FPEE-së duke u bazuar në funksionet e licencës, mirëpo meqë ende nuk është bërë shturja e plotë në mes të OSSH-së dhe FPEE-së, ZRRE e ka pasur të pamundur të bëjë një rialokim të mjeteve në mes të këtyre dy të licencuarve. Siç është theksuar edhe nga ana e KEDS-it, ZRRE në maj të këtij viti ka aprovuar një udhëzues për shturje ligjore të KEDS. Meqë ky proces ende nuk ka përfunduar, ne nuk e kemi bërë një rialokim të këtyre mjeteve dhe momentin e përfundimit të këtij procesi ZRRE zotohet se do të bëjë rialokimn e kostove.

5.2 Kostot e Humbjeve

KEDS ka komentuar edhe në pjesën e parë të këtij dokumenti Metodologjinë e kalkulimit të humbjeve ku është theksuar se ZRRE ka ndryshuar metodologjinë e kalkulimit të humbjeve nga praktikat e mëhershme të procesit të shqyrtimit të MAR-it.

ZRRE e ka sqaruar edhe në Raportet vlerësuese se ndryshimi i metodologjisë së llogaritjes ka për qëllim të reflektojë aplikimin e caktimit të reduktimit të humbjeve në atë pjesë të sistemit të shpërndarjes mbi të cilin KEDS ka ndikim – humbjet teknike dhe komerciale. Kjo është bërë me qëllim që KEDS të mos penalizohet për humbjet që nuk janë nën kontrollin e saj e që kryesisht kanë të bëjnë me furnizimin e pafaturuar në enklava. Ndryshimi i metodologjisë nuk ka ndikim negativ në MAR të KEDS.

Ky koment nuk ka pasur ndikim në vlerësimin fillestar të ZRRE-së.

5.3 Kalkulimi i zhvlerësimit dhe kthimit

KEDS ka komentuar se ka qenë e paqartë mënyra e kalkulimit të zhvlerësimit dhe kthimit nga ana e ZRRE-së në Raportet vlerësuese të saj dhe ka theksuar se nuk do të komentoj lidhur me këtë çështje pa pasur detajet e këtij kalkulimi.

ZRRE në Raportin e saj vlerësues është munduar që të jap shpjegimet e nevojshme për mënyrën e kalkulimit të amortizimit dhe kthimit për të gjithë të licencuarit. Për më tepër, ZRRE në Raportin e saj vlerësues ka prezantuar edhe formulën e cila është në Rregullën për vendosjen e Çmimeve si dhe ndryshimet e nevojshme për shkak të mos-aplikimit të faktorit profilizues gjatë procesit të shqyrtimit periodik. Me qëllim të rritjes së transparencës si dhe sqarimit të plotë të mënyrës se kalkulimit të të gjitha komponentëve të MAR-it, ZRRE ju ka dërguar të licencuarit edhe modelin e kalkulimit të MAR-it. Duhet të theksohet se në proceset e shqyrtimeve periodike ne ju kemi dërguar të gjithë të licencuarve mënyrën e kalkulimit të zhvlerësimit dhe kthimit për periudhën 5 vjeçare dhe gjatë procesit të azhurnimeve vjetore siç është e cekur edhe në rregullën për vendosjen e çmimeve bëhet vetëm indeksimi për nivelin e HICP-së (Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumit).

Po ashtu KEDS ka kundërshtuar aplikimin e nivelit të inflacionit të aplikuar nga ZRRE gjatë kalkulimit të MAR-it për OSSH-në dhe ka theksuar që duhet të përdoret niveli i inflacionit në Kosovë e jo siç ka bërë ZRRE duke e përdorur nivelin e HICP-së të shteteve të BE-së.

ZRRE thekson se kjo është e rregulluar me rregullën për vendosjen e çmimeve dhe nuk mund të ndryshohet nga ZRRE gjatë proceseve të shqyrtimit të MAR-it.

6 MAR-i i Furnizuesit Publik

KEDS ka komentuar se ZRRE-ja gjatë kalkulimeve të MAR-it të Furnizuesit Publik ka reduktuar KREV-in e FPEE-së për vlerat e KREV-it të OST dhe OSSH, duke theksuar se një gjë e tillë nuk është në përputhje me Rregullat e çmimeve.

ZRRE-ja ka theksuar edhe në Raportin vlerësues për MAR-in e FPEE-së se ekziston mundësia e llogaritjes së dyfishtë gjatë aplikimit të përshtatjeve të KREV-it dhe ka ardhur në përfundim se formula e KREV-it, siç është dhënë në Rregullën për Çmimet e FPEE, paraqet llogaritjen e dyfishtë të ndryshimeve mes kostove që bartën të lejuara dhe aktuale të FPEE-së (kostot e OST/OT dhe OSSH).

Në besojmë as KEDS nuk është i interesuar që ti ngarkoj konsumatorët me llogaritje të dyfishtë të KREV-it. Prandaj, ne kemi zbritur KREV-in e FPEE-së për vlerën e KREV-it të OSSH-së dhe OST/OT-së.